 NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/16 Data 16.03 20 26
No. _____ Date _____

PRISHTINË/A



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

RAPORT FINANCIAR TREMUJOR
Për periudhën Tetor – Nëntor – Dhjetor 2025
Tremujori IV (TM4) / 2025

Prishtinë
Janar 2026

NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A Prishtinë
Udhëheqëse e Shërbimit të Kontabilitetit:
Adelina Mustafa

Përmbajtja:

1.Hyrje

2.Shpenzimet TM4-2025 dhe krahasimi me TM4-2024 si dhe struktura e tyre.

3. Të Hyrat TM4-2025 dhe krahasimi me TM4-2024 si dhe struktura e tyre.

1. Hyrje

Në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, konkretisht nenin 14 që rregullon obligimin për raportime financiare periodike, sektori financiar i NPL “Stacioni i Autobusëve” Sh.A. – Prishtinë ka përgatitur raportin financiar për Tremujorin e Katërt të vitit 2025 (Tetor – Nëntor – Dhjetor).

Ky raport ka për qëllim të paraqesë performancën financiare të ndërmarrjes për periudhën e lartpërmendur, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, si dhe krahasimin me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM4/2024). Këto të dhëna i ndihmojnë menaxhmentit në procesin e vlerësimit të performancës dhe planifikimit strategjik për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes.

2.Shpenzimet TM4-2025 dhe krahasimi me TM4-2024 si dhe struktura e tyre.

Krahasimi i shpenzimeve është bërë për periudha të njëjta të viteve 2025 dhe 2024, përkatësisht për Tremujorin e Katërt (Tetor – Nëntor – Dhjetor). Të dhënat janë marrë nga evidencat e kontabilitetit dhe, si të tilla, paraqiten në tabelën më poshtë.

Paraqitja Tabelare e Shpenzimeve TM4-2025 dhe krahasimi me TM4-2024 si dhe struktura e tyre

Përshkrimi	TM4/2025	TM4/2024	Shkalla e uljes/rritjes %	Struktura e Shpenzimeve %
SHPENZIMET E AMORTIZIMIT	24,195.72	0	N/A	4.6
SHPENZIMET E ENERGIJE ELEKTRIKE	8,006.93	2,020.68	296.25	1.7
KOSTO E BILETAVE TE PERJASHTUARA	81,427.60	86,081.40	-5.41	17.6
SHPENZIMET E PAGAVE	319,027.31	235,669.73	35.37	69.1
SHPENZIME PER KONTRIBUTE PENSIONAL – PUNEDHENESI	15,972.33	11,780.78	35.58	3.5
SHPENZIMET KOMUNALE TE UJIT	1,879.09	1,925.21	-2.40	0.4
SHPENZIMET E MBETURINAVE	2,926.39	2,090.28	40.00	0.6
SHPENZIMET E TELEFONIT	403.21	606.33	-33.50	0.1
SHPENZIMET E INTERNETIT	214.83	213.56	0.59	0.0
PROVIZION BANKAR	569.82	471.10	20.96	0.1
SHPENZIMET E REPREZENTACIONIT TE KE-S	1,558.23	2,680.16	-41.86	0.3
SHPENZIMET E DERIVATEVE	305.40	849.39	-64.04	0.1
SHPENZIMET AD HOC	769.78	762.58	0.94	0.2
SHPENZIMET PËR SHPALLJE / REKLAMA, LLOGO	63.00	118.00	-46.61	0.0
SHPENZIMET PAISJE PËR IT	248.82	485.08	-48.71	0.1
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE OBJEKTIT	590.25	772.98	-23.64	0.1
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE MAKINAVE	167.62	809.23	-79.29	0.0
MIRËMBAJTJE DHE FURNIZIM ME SISTEM TË SHITJES SË LAURAVE	2,433.32	4,356.74	-44.15	0.5
SHPENZIMET PËR UJË TË PIJES	227.77	292.37	-22.09	0.0
SHPENZIMET MATJA E TOKZIMIT	645.00	1,592.50	-59.50	0.1
SHPENZIMET E VLERSIMIT TE PRONAVE (ASETEVE) TE L	1,101.69	0.00	N/A	0.2
SHPENZIMET PER ORGANIZIMIN E NDEJES SE FUND VITI	1,762.71	0.00	N/A	0.4
SHPENZIME PËR TAKSA KOMUNALE	0.00	6,229.18	N/A	0.0
ASGJESIMI I ASETEVE	7.00	0.00	N/A	0.0
SHPENZIMET PER ESKURZION PER PUNETORE	3,980.19	-	N/A	0.00
Totali i shpenzimeve TM4 2025/2024	468,484.01	359,807.28	30.20	100.00

Pikat kyçe të raportit të shpenzimeve TM4/2025–TM4/2024

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2025, shpenzimet totale arritën në **468,484.01 €**, duke shënuar një **rritje prej rreth 30.20%** krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (359,807.28 €). Analiza e strukturës së shpenzimeve tregon disa zhvillime të rëndësishme:

1. Peshë kryesore e shpenzimeve – Pagat dhe beneficionet (71.5% e totalit)

Shpenzimet për paga (319,027.31 €) dhe kontribute pensionale (15,972.33 €) përbëjnë **mbi 71.5% të të gjitha shpenzimeve**, duke mbetur kategoria dominues e kostove operative. Rritje të theksuara në disa kategori operative. Disa shpenzime operative kanë shënuar rritje të lartë, duke ndikuar ndjeshëm në diferencën totale. Shpenzimet e energjisë elektrike -nga **2,020.68 €** në **8,006.93 €** – një rritje shumë e madhe, duke përfaqësuar **1.7% të totalit**. kjo rritje ka ndodhur për shkak të rritjes së cmimit të energjisë dhe vonimit të një fature tremujorin e vitit të kaluar. Shpenzime të tjera si shpenzime të reprezentacionit të KE-së ka shënuar ulje të konsiderueshme nga **2,680.16** në **1,558.23**, mirëmbajtje dhe furnizim të shitjes me sistem të laurave nga **4,356.74** në **2,433.32**, shpenzimet matja dhe tokëzimi nga **1,592.50** në **645.00**. Shpenzime të tjera si shpenzimet e vleresimit të pronave (aseteve) dhe shpenzimet e ndejës së fund vitit janë shpenzim shtesë që në periudhën e njëjtë në vitin 2024 nuk kemi pasur.

Shpenzimet për IT, telefon, internet, pajisje dhe arkë fiskale kanë mbetur në nivel minimal (rreth 1% të totalit), duke sugjeruar stabilitet dhe kontroll të mirë të kostove teknike. Shpenzime të vogla, por me devijime nga viti 2024.

Ka kategori ku vitin e kaluar kishte shpenzimë relativisht të lartë, ndërsa në 2025 pothuajse është zero, p.sh.:

- **Shpenzime për taksa komunale** : nga 6,229.18 € → 0 €

Ndërsa kategoritë ku vitin e kaluar nuk kishte shpenzime, në 2025 kemi shpenzime relativisht të larta, p.sh. :

- **Shpenzimet e ndejës së fund vitit**: nga 1,762.71 € → 0 €
- **Shpenzimet e vleresimit të pronave (aseteve)**: nga 1,101.69 € → 0 €
- **Shpenzimet për eskursion të punëtorëve** : nga 3,980.19 → 0€

3. Të hyrat për periudhën TM4-2025

Të hyrat janë të bazuara në të dhënat e evidentuara nga kontabiliteti dhe, si të tilla, paraqiten më poshtë. Krahasimi i të ardhurave është bërë për periudha të njëjta të viteve 2025 dhe 2024, përkatësisht për TM4-2025

Paraqitja Tabelare e te Hyrave per periudhen TM4-2025 në krahasim me TM4-2024

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>	Shkalla e uljes/rritjes %	<u>Struktura e Shpenzimeve</u>
TE HYRAT NGA BILETAT E PERJASHTUARA	71,056.00	75,086.00	(5.34)	15.4
TE HYRAT NGA SHERBIMI BILETAVE	2,780.08	2,781.36	(0.05)	0.6
TE HYRA NGA QERAJA MUJORE UJI	1,271.6	1,251.03	1.64	0.3
TE HYRAT NGA PARKINGU	114,163.36	85,354.58	33.75	24.7
TE HYRAT NGA PERONIZIMI	223,257.51	153,638.98	45.31	48.4
TE HYRA NGA GARDEROBA	958.90	569.07	68.50	0.2
TE HYRAT NGA TARIFA A1, A2	34.64	75.21	(53.94)	0.0
TE HYRAT NGA QERAJA POLIGONIT	3,342.00	635.6	425.80	0.7
TE HYRAT NGA SHP. KANALIZIMIT	158.95	160.71	(1.10)	0.0
TE HYRAT E QERASE MUJORE	71,773.69	38,682.10	85.55	15.6
TE HYRAT E TERASAVE	5,009.02	4,164.36	20.28	1.1
TE HYRAT NGA REKLAMAT VJETORE	1,186.44	1,186.44	0.00	0.3
TE HYRAT NGA NDERRIMI I TARGAVE	50.85	63.56	(20.00)	0.0
HYRJA TEK PERONI	161.02	194.92	(17.39)	0.0
TE HYRAT NGA DENTIMI I LAURES	80.00	0.00	N/A	0.0
TË HYEAT NGA E.ELEKTRIKE	833.92	0.00	N/A	0.2
TË HYRAT NGA PrOVIZIONI 10%	6,231.05	0.00	N/A	1.3
Totali i të hyrave TM4 2025/2024	502,349.02	363,843.92	38.07	100.00

Analizë e Strukturës të të Hyrave TM4 2025/2024

Ky dokument përmbledh analizën e ndryshimeve në të hyrat e Stacionit të Autobusëve për TM4 2025 krahasuar me TM4 2024.

1. Rritja Totale e të Hyrave

- TM4 2025: 502,349.02 €
- TM4 2024: 363,843.92 €
- Rritja totale nga TM4 2024 në TM4 2025 : 138,505.10 €
- Përqindja e rritjes nga TM4 2024 në TM4 2025 : ~38.1%

2. Kontributet Kryesore në Rritje

Arsyet e rritjes në peronizim parking dhe qera është nga Rritja e tarifave për këto kategori të shërbimit :

Zëri	Ndryshimi (€)	Kontributi në rritje
Peronizimi	+69,618.53	45.3%
Parking	+28,808.78	33.8%
Biletat e prejashtuara	+2,201.05	2.9%
Qeraja	+33,091.59	85.55%

Përmirësimi i menaxhimit të peronizimit, parkingut , qerave duket të jetë burimi kryesor i rritjes së të hyrave në TM4 2025.

3.Pasqyra e të ardhurave TM4/2025 dhe krahasimi me TM4/2024

NPL"Stacioni I Autobusëve"Sh.A,prishtinë

NRF:600118245

NU: 811318741

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për tremujorin që përfundon më 31 Dhjetor 2025

	TM4 2025	TM4 2024
	€	€
Të hyrat	502,349.02	363,843.92
Kostoja e shitjes	-81,427.60	-86,081.40
Fitimi/(humbja)bruto	420,921.42	277,762.52
Shpenzimet e shpërndarjes të pagave	-334,999.64	-247,450.51
Shpenzimet administrative / operative	-27,861.05	-26,275.33
Shpenzimet e amortizimit vjetor	-24,195.72	-
Shpenzimet e zhvlerësimit	-	-
Fitimet /humbjet tjera - neto	-	-
Të Shpenzime	-387,056.41	-273,725.84
Fitimi/(humbja) operativ	33,865.01	4,036.68
Fitimi para tatimit	33,865.01	4,036.68
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Fitimi/(humbja)i/e vitit		
Gjithësej të ardhurat/(humbjet)gjithëpërfshirëse të vitit	33,865.01	4,036.68


Pasqyra e të ardhurave paraqet përmbledhjen e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën përkatëse të viteve 2025 dhe 2024. Nga analiza rezulton se në vitin 2025, në raportin TM4, kemi një fitim operativ prej 33,865.01 €, ndërsa në vitin 2024, në të njëjtin raport, fitimi operativ ka qenë 4,036.68€. Diferenca midis TM4 për vitin 2025 dhe TM4 për vitin 2024 është 29,828.33 €.

Shpenzimet për zhvlerësim dhe shpenzimet akruale nuk janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave për periudhën Tetor-Nëntor-Dhjetor të viteve 2025 dhe 2024.

Punoi :

Udhëheqëse e Shërbimit te Kontabilitetit

Adelina Mustafa




Raporti i financave TM4

Aprovuar:

Zyrtarë kryesorë i financave dhe thesarit

Shpend Gjuga



Page 7